

Dr. Musli Vërbani

Shkurorezimi dhe IDDETI

Kaçanik

KAPITULLI I PARË
SHKURORËZIMI

HISTORIA E SHKURORËZIMIT

E drejta e shkurorëzimit ka ekzistuar që nga kohët e vjetra. Ku kjo drejta e shkurorëzimit më së shumti i takonte vetëm burrit.

Në të drejtën e vjetër **babilonase** e drejta e shkurorëzimit i takonte vetëm burrit.

Në të drejtën e vjetër egjiptiane, shkurorëzimi i takonte burrit. Mirëpo pas invazionit maqedonas në Egjipt, sistemi juridik iu afrua atij grek, andaj të drejtë shkurorëzimi iu dha edhe grave.

Në të drejtën kineze, shkurorëzimi mund të bëhet vetëm me marrëveshje të dyanshme dhe me aprovimin e dy palëve. Burri mund ta shkurorëzojë gruan krye më vete në shtatë raste të caktuara. Në rastin e prostitucionit, shkurorëzimi është i domosdoshëm. Burri, bashkëshortja e të cilit e ka tradhtuar, gruan do ta shesë dhe paratë do t'i marrë vet.

Te francezët e vjetër, e drejta e shkurorëzimit i pranohej edhe gruas, por në kushte të caktuara.

Te romakët, deri sa në fillim shkurorëzimi ishte e drejtë vetëm e burrit, me kalimin e kohës dhe zgjerimin e shkurorëzimit pa manus, atë të drejtë e fitojnë edhe gratë.

Në krishterizëm, kisha katolike duke e pranuar parimin se “bashkëshortët janë një trup e jo dy dhe se, atë që e ka bashkuar Zoti nuk duhet ta ndajë njeriu”, me shekuj e kanë ndaluar shkurorëzimin rregullë që kisha i quante “gjendje ku kurora nuk ka vlerë – validitet” nuk ndryshonin shumë nga gjyqet për shkurorëzim.

Reformat që i ka sjell kisha protestante me arsye të caktuara ka aprovuar edhe institucionin e shkurorëzimit.

Nëse përcjellim me vëmendje kronologjinë e shkurorëzimit nëpër kohë shohim se ekzistojnë shumë sisteme juridike të shkurorëzimit, ne në përgjithësi e shkurtojmë sferën e sistemeve juridike të shkurorëzimit në vetëm tri sisteme:

- 1. Sistemi juridik që ndalon kategorikisht shkurorëzimin;**
- 2. Sistemi juridik që liberalizon tej mase shkurorëzimin;**
- 3. Sistemi mesatar, pra në mes të sistemit ndalues dhe liberal të shkurorëzimit.**

Sistemi juridik islam është sistem mesatarë në mes të ndalimit kategorik dhe liberalizimit të pakualifikuar të shkurorëzimit. Islami nuk injoroi realitetin dhe paraqitjen e saj. Një ndalesë kategorike do të ishte e papajtueshme me parimet islame, e cila, sa i përket parimit, përcakton vetëm atë që është e arritshme në mënyrë njerëzore.

Islami, për çiftin bashkëshortor e lejoi ndarjen mes vete atëherë kur mes tyre konstatohet se, në mungesë të dashurisë së sinqertë dhe prehjes shpirtërore nuk mund të arrihet qëllimi final.

Sistemi juridik islam i jep të drejtë burrit për shkurorëzim, por në raste tjera i jep edhe gruas të drejtë për shkurorëzim, e po ashtu i jep të drejtë edhe gjykatës të bëjë shkurorëzimin si e drejtë shoqërore sepse të shkurorëzuarit në të njëjtën kohë janë edhe pjesë e shoqërisë.

SHKURORËZIMI

Nocioni i shkurorëzimit

Me fjalën **shkurorëzim** nënkuptojmë: prishjen e kontratës së martesës përmes mënyrës konkrete apo abstrakte.

Me shkurorëzim kuptojmë **zgjidhjen e një martese të vlefshme gjatë jetës bashkëshortore dhe kjo paraqet përfundimin e një martese të vlefshme.**

Mënyrat e shkurorëzimit

Mënyra e shkurorëzimit shprehet përmes dy formave:

- a. **Përmes shprehjes konkrete dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë; dhe**
- b. **Përmes shprehjes alegorike.**

a. Mënyra e drejtpërdrejtë e shkurorëzimit

Thënia “**je e shkurorëzuar**” është shprehje në kuptim të drejtë dhe nëse burri i drejtohet gruas në këtë mënyrë, në këtë rast fuqizohet shkurorëzimi.

Kur burri i thotë gruas “**je e shkurorëzuar**” dhe këtë nuk e ka thënë me qëllim, prapëseprapë shkurorëzimi bëhet i plotfuqishëm.

Shkurorëzimi mund të bëhet edhe me fjalë të tjera të ngjashme me domethënie të qartë për shkurorëzim, si p.sh., ti je e shkurorëzuar, apo, të kam shkurorëzuar.

b. Mënyra alegorike e shkurorëzimit

Mënyrë alegorike apo e tërthortë konsiderohen shprehjet si, **je e lirë, shko në familjen tënde, mos u kthe më tek unë**, etj.

Me fjalët alegorike edhe pse në shikim të parë nënkuptohet diç tjetër, po që se shprehet me nervozizëm apo me arrogancë në esencë kjo lë të nënkuptosh qëllimin për shkurorëzim.

Te rasti i shkurorëzimit të tërthortë apo alegorik shkurorëzimi nuk konsiderohet valid deri sa të mësohet se çka në të vërtetë ka synuar thënësi i fjalëve të shkurorëzimit.

Dispozita e shkurorëzimit

Edhe pse shkurorëzimi ndonjëherë është i ndaluar, ndonjëherë i lejuar e ndonjëherë i domosdoshëm, ne në këtë sqarim kemi të bëjmë me esencën e shkurorëzimit dhe dispozitën e tij fillestare.

Të gjithë dijetarët janë pajtuar se shkurorëzimi lejohet vetëm në rast nevojë, kur nuk ekziston zgjidhje tjetër më e mirë për problemet e shfaqura midis bashkëshortëve. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: **“Për Allahun, gjëja më e urryer por e lejuar është shkurorëzimi.”**

Disa mendojnë se shkurorëzimi është mekruhi (e urryera) më i afërt me haramin.

Sikur të ishte i ndaluar shkurorëzimi atëherë secila palë do t’iu nënshtrohej problemeve e vuajtjeve të përhershme. Respektivisht, në këso rastesh më së shumti do të dëmtohej femra. Pra, në këtë rast me vetdëshirë vjen deri te shkurorëzimi bashkëshortor duke mos pasur nevojë që për këtë ndarje të ndërhyj e as të intervenojë gjykatësi.

Zoti i Lartëmadhëruar në Kur'an sikur u thotë: **“Jetoni me to (gratë) sa më të mirë. Nëse i urreni ato, bëni durim sepse ndodh që Allahu të japë shumë të mira në një send që ju e urreni.”** (En Nisa : 19)

Arsyet e shkurorëzimit

Shkurorëzimin mund ta kërkojnë vetëm bashkëshortët dhe këtë për arsye të caktuara.

Martesa lidhet me vullnetin e lirë të bashkëshortëve, mirëpo bashkëshortët edhe pse lidhin martesën me vullnet të lirë nuk do të thotë se ata mund të kërkojnë shkurorëzim pa pasur ndonjë arsye.

Sa i përket arsyeve të shkurorëzimit, parashihet se çrregullimi i marrëdhënieve midis bashkëshortëve dhe pamundësia për të përmirësuar ato marrëdhënie qojnë deri te shkurorëzimi.

Arsyet e shkurorëzimit janë :

- Arsyet e përgjithshme të shkurorëzimit; dhe
- Arsyet e veçanta të shkurorëzimit.

Arsyet e përgjithshme mund të quhen çrregullimet serioze ose të vazhdueshme të marrëdhënieve martesore të një shkalle të lartë sa që realizimin e martesës dhe vazhdimin e jetës së përbashkët e bëjnë të pamundur. Si çrregullim serioz dhe i vazhdueshëm i marrëdhënieve bashkëshortore është nëse mes çiftit bashkëshortor nuk dominon harmonia, rehatia, dashuria dhe mëshira mes bashkëshortëve. Ekzistojnë me siguri po aq arsye për shkëputjen e martesës aq sa edhe ato për kontraktimin e saj, me një fjalë arsyet janë të shumta dhe të llojllojshme.

Arsyet e veçanta janë: Jeta e padurueshme e bashkëshortëve dhe disharmonia totale, dhuna, veprime kundër jetës së bashkëshortit tjetër; shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, grindjet e vazhdueshme, urrejtja deri në atë shkallë sa që s'mund të ekzistojë bashkësia familjare, prostitucioni, etj.

Shkurorëzimi është një nga lejitimet më të urryera të Zotit **“Për All-llahun gjëja më e urryer, por e lejuar është shkurorëzimi.”**, gjegjësisht atëherë kur bashkëjetesa vështirësohet dhe kur dy palët gjykojnë se vështirë është të përmirësohen marrëdhëniet midis burrit dhe gruas.

Allahu xh.sh. e lejoi shkurorëzimin si rrugëdalje më të shëndoshë. Kjo bëhet me qëllim që partnerët mos kalojnë jetë të zymtë e me probleme të përhershme.

**E DREJTA E BURRIT PËR SHKURORËZIM
E DREJTA E GRUAS PËR SHKURORËZIM
E DREJTA E GJYKATËS PËR SHKURORËZIM**

E DREJTA E BURRIT PËR SHKURORËZIM

- 1. Shkurorëzimi në bazë të lejitimit apo moslejitimit;**
- 2. Shkurorëzimi me të drejtë kthimi apo moskthimi;**
- 3. Shkurorëzimi në bazë të mënyrës dhe kohës së shkurorëzimit.**

- 1. Shkurorëzimi në bazë të lejitimit apo moslejitimit;**
- 2. Shkurorëzimi me të drejtë kthimi apo moskthimi;**
- 3. Shkurorëzimi në bazë të mënyrës dhe kohës së shkurorëzimit.**

1. Shkurorëzimi në bazë të lejitimit apo moslejitimit:

- a. shkurorëzimi i domosdoshëm;
- b. shkurorëzimi i ndaluar;
- c. shkurorëzimi i lejuar.

2. Shkurorëzimi në bazë të ribashkimit:

- a. shkurorëzimi me të drejtë kthimi, pa akt të ri;
- b. shkurorëzim me të drejtë martese me akt të ri (bain bejnune sugra); dhe
- c. shkurorëzim pa të drejtë kthimi deri sa të martohet me tjetër kë (bain bejnune kubra).

3. Shkurorëzimi në bazë të kohës dhe mënyrës:

- a. shkurorëzimi sunet;
- b. shkurorëzimi bidat.

E DREJTA E GRUAS PËR SHKURORËZIM

- a. Shkuroorëzimi i autorizuar (tefvid);
- b. Shkuroorëzimi i kushtëzuar;
- c. Shkuroorëzimi i quajtur hul'ë (vetëpengimi); dhe
- d. Shkuroorëzimi i quajtur mubareah; marrëveshje e dyanshme.

E DREJTA E GJYKATËS ME PA TË DREJTËN E BASHKËSHORTËVE

- a. Shkuroorëzimi i lianit;
- b. Anulimi i kurorëzimit.

E DREJTA E BURRIT PËR SHKURORËZIM

1. Shkurorëzimi në bazë të lejimit apo moslejimit kategorizohet në:

- a. Shkurorëzimi i domosdoshëm;
- b. Shkurorëzimi i ndaluar;
- c. Shkurorëzimi i lejuar.

Shkurorëzimi në bazë të lejimit apo moslejimit

a. shkurorëzimi i domosdoshëm:

Shkurorëzimi i domosdoshëm është kur:

- gruaja është jobesnike apo mospërfillëse apo e pavëmendshme ndaj detyrave të saj;
- aty ku nuk ekziston mënyrë e përfytyrueshme për pajtim ose shpresë për paqe ndërmjet palëve.

b. shkurorëzimi i ndaluar.

Është e ndaluar që shkurorëzimi të bëhet në rastin kur nuk ka ndonjë arsye të mirë për të, për shkak se ai do të ishte i dëmshëm, ndërsa muslimanëve feja e tyre ua ndalon që t'i shkaktojnë dëm ose ta lëndojnë njëri-tjetrin.

Shkurorëzimi nuk guxon të jetë përfundim i pakonsultuar me të gjitha metodat për zgjidhjen e konfliktit.

Disa dijetarë mendojnë se shkurorëzimi që dëmton burrin e gruan dhe e shkatërron interesin e të dyve pa arsye, si p.sh. harxhimi i pasurisë, i cili konsiderohet i ndaluar. Pejgamberi a.s. thotë: **“Mos dëmtoni veten e as të tjerët!”**. Është i ndaluar shkurorëzimi që nuk ka ndonjë arsye të mirë për të, për shkak se ai do të ishte i dëmshëm, ndërsa muslimanëve feja e tyre ua ndalon që t'i shkaktojnë dëm ose ta lëndojnë njëri-tjetrin, si dhe ndalohet për njeriun i cili nuk ka arsye për shkurorëzim dhe që dëshiron të formojë kushte për prostitucion.

c. shkurorëzimi i lejuar.

Shkurorëzimi është i lejuar:

- kur për të ka baza të shëndosha, siç është mospërfillja e përsëritur apo dështimi në përmbushjen e qëllimeve të martesës, edhe nëse është cilësuar si gjëja më e urryer te Zoti i Lartmadhëruar nga të gjitha gjërat e lejuara.

Shkurorëzimi në bazë të ribashkimit

2. Shkurorëzimi në bazë të ribashkimit:

- a. shkurorëzimi me të drejtë kthimi, pa akt të ri;
- b. shkurorëzim me të drejtë martese me akt të ri (bain bejnune sugra); dhe
- c. shkurorëzim pa të drejtë kthimi deri sa të martohet me tjetër kë (bain bejnune kubra).

a. shkurorëzimi me të drejtë kthimi pa akt të ri (talak rekh'ij)

Shkurorëzimi me të drejtë (talak rekh'ij) është lloj shkurorëzimi i cili nuk mënjanon dispozitat e bashkëshortësisë. Ndryshe mund ta konsiderojmë si parashkurorëzim apo shkurorëzim preliminarë.

Deri sa të zgjatë IDDETI gruaja qëndron në shtëpinë e burrit i cili e ka shkurorëzuar. Qëndrimi i saj gjatë IDDETIT në shtëpinë e burrit të saj konsiderohet **shkurorëzim kthyes** dhe mund të rikthehet pa kontratë dhe mehr të ri dhe ai shkurorëzim quhet vetëm shkurorëzim me të drejtë kthimi me fjalë tjera preliminarë.

Gjatë këtij lloji të shkurorëzimit, bashkëshortësia akoma vazhdon të mbetet përderisa gruaja e shkurorëzuar është në ditët e **iddetit**, andaj burri duhet ta rikthejë brenda kësaj periudhe.

Nëse nuk e rikthen brenda periudhës së iddetit, atëherë ajo në këtë rast ndahet dhe shkon në shtëpinë e vet dhe është e lirë, me ç'rast ky nuk posedon të drejtë rikthimi pos me pëlqimin paraprak të gruas.

Efektet juridike të shkurorëzimit me të drejtë kthimi (talaki rekh'ij)

Efektet juridike të këtij shkurorëzimi janë si në vijim:

- Konsiderohet shkurorëzim me të drejtë kthimi (talak rekh'ij), që do të thotë deri në kalimin e IDDETIT (tri kohëra të pastrimit),
- Gjatë kohës së IDDETIT ka të drejtë:- të martohet pa akt të ri, pa dëshmitarë dhe pa mehr të ri.
- Gjatë kohës së IDDETIT gruaja e shkurorëzuar patjetër duhet të qëndrojë në shtëpinë e burrit deri sa të kalojë IDDETI, (e ajo kohë është tre menstruacione) .
- Gjatë kohës së IDDETIT kujdesin për ushqim dhe veshmbathje e ka burri prej shpenzimeve të tij.
- Nuk ka të drejtë të martohet kurrë me vajzën e kësaj gruaje të shkurorëzuar (sepse bëhet ndalesë e përgjithshmonshme); dhe
- Burri nuk ka të drejtë të martohet me motrën e saj deri sa ajo është në iddet , ndërsa pas IDDETIT ka të drejtë të martohet me motrën e saj;
- **TEHLILE**: Ka të drejtë të martohet me burrin e mëhershëm, i cili e ka shkurorëzuar tri herë, sepse e ka përjetuar aktin seksual (asijletuhu);
- **E drejta e trashëgimisë**: Nëse ndonjëri prej bashkëshortëve vdes gjatë kohës së IDDETIT të gruas (tri kohëra të pastrimit), ka të drejtë trashëgimie (1/8 nëse ka pasë ndonjëri fëmijë me grua tjetër, ose 1/4 nëse nuk kanë fëmijë);
- **E drejta e mehrit**: Gruaja e merr mehrin të cilin e ka në pronësi të vet, sepse mehr i asnjëherë nuk është në pronësi të bashkëshortit.

b. Shkurorëzim me të drejtë martese me akt të ri (bain bejnune sugra)

Burri gruan e shkurorëzon pas menstruacionit dhe në fillim të IDDETIT kur nuk kryen marrëdhënie intime.

Deri sa të jetë në IDDET ka rast që ta rikthej sepse është shkurorëzim preliminarë.

Nëse gruas pas shkurorëzimit me të drejtë kthimi (talak rekh'ij) i kalon IDDETI ndërsa burri nuk e rikthen në jetën bashkëshortore brenda këtij afati, atëherë ky shkurorëzim prej shkurorëzimit preliminarë shndërrohet në shkurorëzim faktik parapërfundimtarë (**në bain bejnune sugra**), që do të thotë se, burri më nuk e posedon të drejtën e rikthimit pa kontratë të re dhe me mehr të ri.

Shkurorëzimi parapërfundimtarë pason pas kalimit të IDDETIT pas së cilës skadon kontrata martesore dhe nuk ka të drejtë rikthimi.

Rikthimi eventual pas afatit kohor tremujor mund të ndodh, por vetëm me pajtimin e gruas, dhe duhet të lidhet medoemos kontrata e re martesore dhe të përcaktohet mehr i ri.

Gruaja në rast se pas kësaj kohe nuk do që të i rikthehet burrit të vet, nuk ka të drejtë askush të bëjë presion apo lutje eventuale për rikthim, pasi që është e drejtë e plotë e saj për të marrë një vendim të tillë.

Efektet juridike të shkurorëzimit me të drejtë martese me akt të ri (bejnunetul sugra)

Efektet juridike të këtij shkurorëzimi janë si në vijim:

- Konsiderohet shkurorëzim me të drejtë kthimi (Talak Rexh'ij), që do të thotë deri në kalimin e iddetit (tri kohëra të pastrimit), e ajo kohë është tre menstruacione dhe numërohet si shkurorëzim;

- ka të drejtë të martohet me cilin dëshiron ajo; me akt të ri, me dëshmitarë dhe me mehr të ri.

- Para përsëritjes së kontratës së re është i ndaluar takimi dhe qëndrimi i tyre në vetmi.

- Nuk ka të drejtë të martohet kurrë me vajzën e kësaj gruaje të shkurorëzuar (sepse bëhet ndalesë e përgjithmonshme);

- ka të drejtë të martohet me motrën e saj, pasi i ka kaluar IDDETI, ndërsa para kësaj kohe nuk ka pasur të drejtë të martohet me motrën e saj;

- **TEHLILE:** Ka të drejtë të martohet me burrin e mëhershëm, i cili e ka shkurorëzuar tri herë, sepse e ka përjetuar aktin seksual (asijletuhu);

- **Nuk ka të drejtë trashëgimie:** Nëse ndonjëri prej bashkëshortëve vdes pas iddetit të gruas (tri kohëra të pastrimit), nuk e trashëgojnë njëri-tjetrin;

- **E drejta e mehrit:** Gruaja e merr mehrin të cilin e ka në pronësi të vet, sepse mehr i asnjëherë nuk është në pronësi të bashkëshortit.

c. Shkurorëzimi përfundimtarë (bain bejnunetul kubra)

Burrit i lejohen vetëm tri shkurorëzime.

Çdo shkurorëzim kushtëzohet të bëhet në periudhën e pastërtisë së gruas, pra pas menstruacionit, kur edhe s'ka pasur marrëdhënie seksuale me të. Kjo mund të pasqyrohet si në vijim:

Burri e shkurorëzon e gruan një herë dhe pret kalimin e iddetit. Gjatë periudhës së iddetit mund ta rikthejë. Nëse kjo periudhë kalon, atëherë janë plotësisht të shkurorëzuar dhe secili prej tyre ka të drejtë të martohet me ndonjë tjetër.

Nëse pas një kohe e shkurorëzon dhe prapë e shkurorëzon dhe prapë e rikthen llogariten dy shkurorëzime.

Nëse martohet për të tretën herë dhe e shkurorëzon për të tretën herë, më nuk ka të drejtë rikthimi dhe i bëhet ndalesë e përkohshme e cila quhet shkurorëzim përfundimtarë **bain bejnune kubra**.

Kjo do të thotë se nëse e shkurorëzon gruan për të tretën herë, atëherë kuptohet se është absurde që të jetojnë së bashku, dhe për këtë shkak nuk i lejohet (burrit) ta rikthejë pas shkurorëzimit të tretë përderisa gruaja të martohet me burrë tjetër, edhe ajo martesë të jetë ligjore, e vërtetë dhe jo vetëm për t'ia mundësuar rikthimin te burri i parë.

Ky lloj shkurorëzimi nuk lejon më rikthim as me kontratë të re dhe meher të ri. Në këtë rast rikthimi mund të vjen në shprehje vetëm si në vijim:

Pasi gruaja e shkurorëzuar për të tretën herë, martohet me ndonjë tjetër me të cilin kryen marrëdhënie të plota seksuale dhe, nëse edhe prej burrit tjetër shkurorëzohet, pra, vetëm atëherë pas kalimit të periudhës së iddetit burri i mëparshëm mund ta rikthejë gruan edhe atë, nëse vetë ajo shpreh dëshirë për t'u rikthyer.

Pas kësaj, burri i parë mund të lidhë sërish akt martese me të. Kur'ani përcakton në suren "Et-Talak" një shtyrje të deklaratës së martesës deri në fund të fazës së ardhshme ku gjatë deklaratës përfundimtare të ndarjes duhet të jenë prezentë, sipas sures së mësipërme, dy dëshmitarë të besueshëm.

Këtë dijetarët e mbështesin në ajetin kur'anor ku Allahu xh.sh. në lidhje me këtë thotë:

"E në qoftë se ai (burri) e shkurorëzon atë (për herë të tretë), pas atij (shkurorëzimi) nuk lejohet më derisa të martohet ajo për një burrë tjetër. E nëse ai (burri i dytë) e shkurorëzon atë, atëherë për ata dy, po qe se mendojnë se do t'i zbatojnë dispozitat e Allahut, nuk ka pengesë të rikthehen (në bashkëshortësi). (El Bekare)

Efektet juridike të shkurorëzimit përfundimtarë (bejnunetul kubra)

– **Konsiderohet shkurorëzim me pa të drejtë kthimi**, që do të thotë deri në martesën me ndonjë burrë tjetër, e nëse burri tjetër e shkurorëzon mund të vjen në pyetje të martohet me të me dëshmitarë dhe me mehr të ri.

– ka të drejtë të martohet me cilin dëshiron ajo; me akt të ri, me dëshmitarë dhe me mehr të ri.

– Para përsëritjes së kontratës së re është i ndaluar takimi dhe qëndrimi i tyre në vetmi.

– Nuk ka të drejtë të martohet kurrë me vajzën e kësaj gruaje të shkurorëzuar (sepse bëhet ndalesë e përgjithmonshme);

– ka të drejtë të martohet me motrën e saj, pasi i ka kaluar IDDETI , ndërsa para kësaj kohe nuk ka pasur të drejtë të martohet me motrën e saj;

– **TEHLILE:** Ka të drejtë të martohet me burrin e mëhershëm, i cili e ka shkurorëzuar tri herë, sepse e ka përjetuar aktin seksual (asijletuhu);

– **Nuk ka të drejtë trashëgimie:** Nëse ndonjëri prej bashkëshortëve vdes pas iddetit të gruas (tri kohëra të pastrimit) nuk e trashëgojnë njëri-tjetrin.

– **E drejta e mehrit:** Gruaja e merr mehrin të cilin e ka në pronësi të vet, sepse mehr i asnjëherë nuk është në pronësi të bashkëshortit.

Shkurorëzimi në bazë të kohës dhe mënyrës

2. Shkurorëzimi në bazë të kohës dhe mënyrës:

- a. shkurorëzimi sunet; dhe**
- b. shkurorëzimi bidat.**

a. Shkurorëzimi sunet

Shkurorëzimi sunet është shkurorëzimi që i përgjigjet sunetit. Këtu *sunet* do të thotë *rrugë dhe rregull* që duhet ndjekur në shkurorëzim e që është urdhëruar nga ana e Zotit e nuk do të thotë sunet, kryerja e së cilës meriton shpërblim.

Shkurorëzimi sunet është ndarje me gruan, me të cilën është hyrë në periudhën e pastërtisë (periudhën e kaluar midis menstruacioneve), periudhë në të cilën nuk hyhet në marrëdhënie seksuale.

Periudha e menstruacionit e obligon burrin të largohet nga marrëdhënia intime me gruan, kështu që ai duhet ta presë mbarimin e menstruacionit e pastaj ta shkurorëzojë pa kontaktuar intimisht.

Ashtu siç ndalohet shkurorëzimi gjatë menstruacionit, gjithashtu ndalohet edhe pas marrëdhënieve intime gjatë periudhës së pastërtisë së saj, sepse ekziston mundësia e shtatzënisë, dhe ka mundësi që kur të kuptojë burri se gruaja e tij është me barrë ta ndërrojë mendimin e ndarjes për hir të fëmijës së posanisur në barkun e saj.

Në qoftë se ajo është e pastër, ose e di se është shtatzënë dhe edhe më tutje insiston ta shkurorëzojë, atëherë kuptohet se shkurorëzimi është pasojë e antipatisë së thellë dhe në këtë rast i lejohej ta lëshojë.

Shkurorëzimi i rregullt (Sunet) është ky:

- Shkurorëzohet në muajin e parë pas menstruacionit në kohën e pastërtisë pa kontaktuar intimisht (NJË SHKURORËZIM);
- Shkurorëzohet në muajin e dytë pas menstruacionit, në kohën e pastërtisë pa kontaktuar intimisht (DY SHKURORËZIME);
- Shkurorëzohet në muajin e tretë pas menstruacionit, në kohën e pastërtisë pa kontaktuar intimisht (TRE SHKURORËZIME).

Gjithsejt TRE MUAJ NË TRE SHKURORËZIME.

Shkurorëzimi më i rregullt (Suneti ehsen). Kjo është mënyrë më e mirë e shkurorëzimit, mund të bëhet gjatë rreth nëntë muajve.

- Shkurorëzohet në muajin e parë pas menstruacionit në kohën e pastërtisë pa kontaktuar intimisht (NJË SHKURORËZIM);
- Shkurorëzohet në muajin e katërt pas menstruacionit, në kohën e pastërtisë pa kontaktuar intimisht (DY SHKURORËZIME);
- Shkurorëzohet në muajin e shtatë pas menstruacionit, në kohën e pastërtisë pa kontaktuar intimisht (TRE SHKURORËZIME).

Në çdo tre muaj nga një shkurorëzim (jo në çdo muaj), pra tri herë nga tre menstruacione.

Ky proces lidhet me faktin se ndalohen marrëdhëniet seksuale midis bashkëshortëve derisa femra është në ciklin menstrual, dhe kjo shkakton nervozizëm tek mashkulli, kështu që ai duhet ta presë mbarimin e ciklit menstrual të gruas e pastaj ta shkurorëzojë dhe atë pa ju afruar fare (pa bërë marrëdhënie seksuale).

b. Shkurorëzimi bidat (shkurorëzimi i çrregullt)

Shkurorëzimi bidat është në kundërshtim me shkurorëzimin sunet. Quhet **shkurorëzim bidat** sepse bëhet në kohën kur gruaja është në periudhë të menstruacionit ose atë të pastrimit pasi të ketë kontaktuar intimisht.

Në qoftë se ndërmerret hapi i shkurorëzimit, duhet ta zgjedhë mënyrën dhe kohën e përshtatshme, ngase nuk i lejohet që të veprojë sipas dëshirës. Ekzistojnë edhe kufizime sa i përket kohës se kur duhet të bëhet shkurorëzimi.

Gruaja në jetën e vet kalon në dy faza:

E para: Faza kur i ka menstruacionet; dhe

E dyta: Faza kur është në kohën e pastërtisë së saj (jo në fazën e menstruacionit).

Nuk lejohet të bëhet shkurorëzimi kur femra është në fazën e menstruacionit, me fjalë tjera nuk lejohet të bëhet shkurorëzimi derisa femra të kalojë në tërësi këtë kohë edhe pse në këtë kohë është e ndaluar të kontaktoj intimisht. Po që se kontaktojnë intimisht pas menstruacionit ekziston mundësia e shtatzënisë, dhe kur të kuptojë burri se gruaja e tij është shtatzënë mund të ndryshoj mendimin për hir të fëmijës së nisur në barkun e saj.

Nuk lejohet në kohën e IDDETIT pasi të kontaktohet intimisht. Shkurorëzimi bëhet në fillim të pastërtisë së grave. Zoti i Madhëruar thotë: **“O ti Pejgamber, kur të lëshoni gratë, lëshoni ato në vigjilje të fillimit të pritjes së tyre (në kohën e pastërtisë)!”** (Talak, 1)

Koha e përshtatshme nënkupton gruan e pastër pa menstruacion dhe jo në fazën e lehonisë, dhe kohën kur nuk ka pasur marrëdhënie seksuale para ciklit të fundit. Në qoftë se gruaja është shtatzënë, atëherë burri duhet të jetë i njoftuar. Në kohën e menstruacioneve e obligon burrin të largohet nga marrëdhënia intime me gruan.

Argumenti i shkurorëzimit bidat

Transmetohet se **Abdull-llah ibn Umeri e ka lëshuar gruan e tij kur ajo ka pasur menstruacione**. Kur e ka pyetur Umer ibn Hattabi Pejgamberin a.s. për këtë çështje, pejgamberi a.s. i ka thënë: **“Thuaji le ta kthejë, e pastaj kur të jetë e pastër dhe e paprekur, si të dojë le ta shkurorëzojë.”**

Dijetarët janë pajtuar se shkurorëzimi bidat është haram. Ndaj, kthimi i burrit tek gruaja që e shkurorëzoi me llojin e shkurorëzimit bidat është farz. Dijetarët janë të pajtimit se, edhe pse është haram shkurorëzimi bidat prapëseprapë ai pranohet si i tillë. Kjo i ngjanë faljes së namazit në një copë toke që është grabitur në mënyrë të padrejtë nga të tjerët, pra edhe uzurpimi i tokës së huaj është haram, namazi pranohet, por personi ende është në tokën e uzurpuar e cila është haram.

Shkurorëzimi nga ana e gruas

- a. Shkurorëzimi i autorizuar (tefvid);
- b. Shkurorëzimi i kushtëzuar;
- c. Shkurorëzimi i quajtur hul'ë (vetëpengimi); dhe
- d. Shkurorëzimi i quajtur mubareah; marrëveshje e dyanshme.

a. Shkurorëzimi i autorizuar (tefvid)

Çdo e drejtë korrespondon me një obligim; gruaja njësoj si edhe burri, ka të drejtë që pavarësisht të fillojë dhe në të vërtetë ta shkëpusë lidhjen bashkëshortore.

TEFVID quhet e drejta e shkurorëzimit e cila mund t'i jepet edhe gruas nga ana e bashkëshortit në momentin e kurorëzimit.

Në kryerjen e aktit të kurorës, burri që ka autorizim për shkurorëzim, mundet që gruas t'i jep të drejtë shkurorëzimi kur të dëshirojë vetë ajo. Kjo quhet "TEFVID".

Burri mund ta japë këtë të drejtë edhe pas aktit të kurorëzimit. Ai do të përcaktojë dhe do të vërtetojë formën e shkurorëzimit dhe numrin e shprehjeve për shkurorëzim.

Gruaja mund ta shfrytëzojë këtë të drejtë vetëm në kushte të caktuara.

Burri nuk mund ta tërheq autorizimin që ia ka dhënë gruas.

b. Shkurorëzim i kushtëzuar

Shkurorëzimi i kushtëzuar është shkurorëzimi i llojit në të cilin burri, në kohën e kontraktimit të martesës, kushtëzon se po qe se ai bën diçka të kundërt me dëshirën e gruas së tij, ajo do të jetë e lirë të shkurorëzohet nga ai.

Pëlqimi i burrit për kërkesën e saj është i papërfillshëm, po qe se ajo ka arsye të vlefshme për shkurorëzim.

Në këtë rast bëhet detyrë e autoriteteve të caktuara që asaj t'ia mundësojnë fitimin e lirisë nga lidhja martesore.

c. Shkurorëzimi i quajtur hul'ë (vetëpengimi)

Një e drejtë prej të drejtave të gruas për shkurorëzim është shkurorëzimi i quajtur HUL'Ë.

Hul'ë është shkurorëzimi i tërhjeqjes së gruas nga e drejta e saj e mehrit (dhurata e burrit). Me fjalë tjera *shkurorëzim me kompensim*.

Ky lloj shkurorëzimi ka të bëjë me të drejtën e gruas për shkurorëzim. Mehri që gruaja e fiton gjatë aktit të kurorëzimit prej bashkëshortit të saj i takon vetëm asaj. Burri asgjë nuk mund të marrë nga sa të jetë i kurorëzuar ajo disponon e pavarur me atë pasuri por edhe pasuri tjetër të cilën e fiton.

Që gruaja të kërkojë ndarje edhe nëse burri nuk dëshiron ta shkurorëzojë atë, mirëpo ajo këtë rast duhet ta paraqesë, duke i sqaruar arsyet, në gjykatë (Islame), mirëpo në këtë rast gruaja detyrohet që t'ia kthejë burrit mehrin (dhuratën) që e ka pranuar nga ai gjatë martesës.

Hul'i është e lejueshme vetëm për ato arsye, për të cilat ajo nuk mban përgjegjësi: mungesa e sigurimit të mjeteve të jetesës nga ana e burrit dhe lënia pas dore seksualisht prej tij (tre muaj ose më shumë pa marrëdhënie seksuale). Në këto dy raste ajo duhet të ngrejë padi tek një gjykatës, i cili pastaj vendos realizimin e ndarjes.

Gruaja e cila e urren burrin e vet dhe s'mund të jetojë bashkë me të ka të drejtë të lirohet nga martesa duke ia kthyer burrit të vet mehrin e paguar dhe dhuratat e dhuruara nga ai, ose kthimi do të realizohet varësisht nga pëlqimi i ndërsjellë, gjegjësisht më pak apo më shumë. Preferohet që ai të mos kërkojë më shumë se sa i ka dhënë. Zoti i Madhëruar thotë: **“E nëse kini frikë se ata të dy nuk do të mund t'i ruajnë dispozitat e All-llahut, atëherë për atë me çka ajo bën kompensim, për ata të dy nuk ka mëkate.”** (El-Bekare, 229)

Argument i shkurorëzimit të HUL'IT

Rasti i sahabiut të quajtur Thabit bin Kajs i cili ishte i martuar me një grua, por ky në fizionomi ishte i shkurtër dhe i zi. Gruaja e tij shkon te Muhamedi a.s dhe i thotë: **“O i Dërguar i Allahut, Thabit bin Kajsin nuk e qortoj në moral dhe fe, por e urrej kthimit në kufër pas besimit dhe natyrës së burrit tim, por nuk po mundem ta duroj (ta dashuroj). Si një muslimane, nuk dëshiroj të jem shpirtligë** (frikësohem nga mosplotësimi i obligimeve të mia ndaj tij, meqë assesi nuk mund ta dashuroj). Muhamedi a.s i thotë: **“A do t'ia kthesh kopshtin e tij** (që i'a kishte dhuruar Thabiti si mehër gjatë martesës)? Ajo thotë: **“Po”**. Muhamedi a.s i thotë Thabitit: **“Pranoje kopshtin dhe ndaje atë nga ti përgjithmonë.”**

Po që se mosmarrëveshja ka filluar nga ana e burrit, ai duhet të ndahet pa e marrë mehrin dhe në atë rast kemi të bëjmë me të drejtën e gruas për prishje apo abrogim të martesës (nuk quhet shkurorëzim) dhe nuk quhet HUL'Ë por FES'HI nuk i nënshtrohet kompensimeve nga ana e gruas siç është rasti me shkurorëzimin **HUL'Ë**.

Nga kjo përfundojmë me atë se, është haram që burri ta detyrojë gruan të kërkojë shkurorëzim me qëllim të fitoj të drejtën e kompensimit, e as ta keqtrajtojë.

d. Shkurorëzimi mubareah - me pëlqim reciprok

Shkurorëzimi mubareah është lloji i shkurorëzimit me marrëveshje të të dy palëve, do të thotë me pëlqimin paraprak edhe të burrit edhe të gruas.

Zgjidhja e martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve, bazohet në një marrëveshje reciproke të përbashkët të tyre, e cila ka për qëllim dhënien fund të martesës që ekziston midis dy bashkëshortëve.

Nga parashikimet e këtyre dispozitave përcaktohet se si procedohet nëpërmjet zgjidhjes së martesës.

Dy bashkëshortët mund të akordohen për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, nëse janë marrë vesh njëri me tjetrin për zgjidhjen e saj.

Shkurorëzimi përmes pëlqimit reciprok është kur burri edhe gruaja personalisht pajtohen që në mënyrë paqësore ta shkëpusin lidhjen bashkëshortore. Atëherë kur u ka humbur shpresa që t'i plotësojnë dispozitat e kurorës, shkurorëzimi në këtë rast nuk është mëkat për asnjërën nga palët.

Një marrëveshje e ndërsjellë bilaterale (e dyanshme) për përfundimin e martesës dhe për ta liruar njëri-tjetrin nga lidhja bashkëshortore. Gjyqi do t'i imponojë kushtet e tyre dhe do të intervenojë vetëm atëherë, po qe se ka kushtëzime të paligjshme.

Nëse burri eventualisht ia jep të drejtën e vetëpërcaktimit, do të thotë nëse burri ia lë gruas të drejtën të vendosë për shkurorëzim. Kërkimit të kësaj ndarjeje nga ana e gruas duhet t'i paraprijnë disa shkaqe. Si f.v., për shkak të grindjes dhe konfliktit në mes çiftit bashkëshortor për arsye të qëndrueshme, si mosrealizimi i përkujdesjes së burrit ndaj gruas, mangësive trupore, ndonjë sëmundje që pamundëson bashkëjetesën, etj.

Gjyqi do t'i imponojë kushtet e tyre dhe do të intervenojë vetëm atëherë, po qe se ka kushtëzime të paligjshme.

E drejta e gjykatës për shkurorëzim

- a. Shkurorëzimi i lianit;**
- b. Anulimi i kurorëzimit.**

a. Shkurorëzim i quajtur lian (dëshmimi i dyfishtë apo mallkimi i ndërsjellë)

Shkurorëzimi përmes procesit gjyqësor. Në këtë kategori bën pjesë shkëputja e martesës përmes vendimit të gjykatës islame, me ose pa pëlqimin e palëve. Përfundimi i një martese të tillë nuk është çështje private por është çështje shoqërore e cila tërheq pas vete edhe autoritetet juridike dhe ato ekzekutive. Kjo rregullohet me **Lianin** - vetmallkimet e dyfishta të bashkëshortëve të cilat e zëvendësojnë dëshminë e tyre dhe të drejtën e tyre.

Lian do të thotë përбетim me mallkim në mes të bashkëshortëve, në mungesë të dëshmitarëve në rast akuze për prostitucion. Pra, nëse burri akuzon gruan për prostitucion, ndërsa ajo e demanton dhe e mohon një gjë të tillë, atëherë, para gjykatës, nga të dy palët, bëhet katër herë përбетimi dhe të pestën herë mallkimi.

Ky lloj shkurorëzimi bëhet me rastin kur burri e akuzon gruan për prostitucion, mirëpo nuk ka dëshmitarë të cilët e dëshmojnë këtë dhe ai nuk ka fakte, por kjo në vetvete nuk do të thotë se gruaja ka bërë prostitucion pasi ajo mund të jetë e moralshme dhe e pastër, por burri dyshon në të.

Ky lloj shkurorëzimi bëhet me përбетimin e dyfishtë apo mallkimin e ndërsjellë.

Përбетimi burrit (vetmallkimi i burrit):

“Ndërsa ata, të cilët shpifin për gratë e veta dhe nuk kanë dëshmitar tjetër pos vetes, dëshmimi i çdonjërit prej tyre është: të betohen katër herë në Allahun, se thonë të vërtetën. E pesta (herë e betimit) është: Mallkimi i Allahut qoftë mbi të, nëse ai gënjen.” (En Nur : 6, 7)

Përбетimi i gruas (vetmallkimi i gruas)

“E nga ajo (gruaja e shpifur) largohet dënimi, nëse katër herë betohet në Allahun, se ai (shpifësi) gënjen. E pesta herë e betimit të jetë që ta godasë hidhërimi i Allahut atë (gruan), nëse shpifja ka qenë e vërtetë.” (En Nur : 8, 9)

Pas kësaj, gjykatësi vendos ndarje në mes tyre.

Efektet Juridike të shkurorëzimit të lianit (me vetmallkim)

Efektet juridike të shkurorëzimit lian janë si në vijim:

- bashkëshortët nuk kanë të drejtë të vazhdojnë bashkëshortësinë;
- ndalesë martese e përgjithmonshme në mes tyre.

b. Anulimi i kurorëzimit

Anulimi i martesës është mënyrë gjyqësore e zgjidhjes së martesës së pavlefshme dhe trajtohet sikurse martesa të mos jetë lidhur fare.

Kurorëzimi në të cilin kontrata martesore është konstatuar si e pavlefshme apo jocomplete dhe se duhet anuluar. Në këtë kategori shkurorëzimi bën pjesë shkëputja e martesës përmes vendimit të ndonjë trupi gjyqësor, me ose pa pëlqimin e palëve.

Dallimi në mes të shkurorëzimit dhe anulimit të martesës

Shkurorëzimi dallon thelbësisht nga anulimi i martesës, sepse :

- **anulimi** i martesës është zgjidhje e një martese të pavlefshme, ndërsa
- **shkurorëzimi** është zgjidhje e një martese të vlefshme.

Ky lloj Shkurorëzimi nënkupton zgjidhjen e një martese të plotëfuqishme gjatë jetës së bashkëshortëve, në procedurë gjyqësore, për shkaqe të përcaktuara me ligj si f.v. Lidhja e gjinisë (gjinia gjakut, krushqisë). Mungesa e vullnetit gjatë aktit të martesës (nën ndikimin e dhunës, kanosjes, mashtrimit ose lajthimit).

Përfundimi i marrëdhënies bashkëshortore nuk është një brengë private e të fajësuarve kryesorë, por, ajo i tërheq pas vete edhe autoritetet juridike dhe ato ekzekutive.

Procesi deri te shkurorëzimi

Nëse mosmarrëveshja ose disharmonia midis bashkëshortëve nuk mund të evitohet nga vetë bashkëshortët, atëherë emërohen dy ndërmjetësues nga dy familjet e të kurorëzuarve.

Ndërmjetësuesit duhet të bëjnë përpjekje që t'i pajtojnë. Këtë proces e tregon ajeti kur'anor:

"Nëse i frikësohen përçarjes mes tyre (burrit e gruas), dërgoni një pari të drejtë nga familja e tij dhe një pari të drejtë nga familja e saj. Nëse ata të dy (ndërmjetësuesit) kanë për qëllim pajtimin, All-llahu ju mundëson afrimin mes tyre (burrit e gruas)..." (En Nisa : 35)

Konflikti ndonjëherë s'mund të mënjanohet edhe pse bëhen përpjekje me qëllime të mira. Një brengë e këtillë t'i shkaktohet qenies njerëzore nuk përkon me mëshirën.

Nëse ndërmjetësuesit nuk kanë sukses që t'i pajtojnë pas të gjitha përpjekjeve të tyre dhe nëse dakordohen t'i shkurorëzojnë, një gjykim i këtillë do të jetë i plotfuqishëm.

Pas shfrytëzimit të masave dhe metodave për pajtimin e bashkëshortëve, emërimit të ndërmjetësuesve, më pastaj u thuhet:

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Jetoni me to (gratë) sa më të mirë. Nëse i urreni ato, bëni durim pse ndodh që Allahu të japë shumë të mira në një send që ju e urreni."** (En Nisa : 19)

Në fund, pas gjitha përpjekjeve kur nuk ka mundësi të vazhdojnë bashkëshortësinë vjen pika e fundit ku duhet ta dinë dhe ta kenë në mendje ajetin kur'anor:

"Por, nëse ndahen prej njëri tjetrit, All-llahu begaton me mirësinë e Tij secilin prej tyre. All-llahu është Bujar i Madh, i Plotëdijshëm."

All-llahu i Lartësuar pa dyshim se e di më së miri për çdo punë të njeriut, për çështjen e shkurorëzimit thotë:

"E kur t'i keni lëshuar gratë, dhe ato i afrohen afatit të tyre, a atëherë ose i mbani si duhet, ose i leni si duhet, e mos i mbani sa për t'i dëmtuar, e të bëheni të padrejtë. E kush bën atë, ai e ka dëmtuar vetveten. Dispozitat e All-llahut mos i merrni për shaka."

Gjendjet në të cilat pranohet dhe gjendjet në të cilat nuk pranohet shkurorëzimi

Shkurorëzimi me dhunë dhe me detyrim

Shkurorëzimi me dhunë llogaritet shkurorëzim i vlefshëm.

Shkurorëzimi i të dehurit

Shkurorëzimi i të dehurit e llogaritet i vlefshëm.

Nuk është i vlefshëm shkurorëzimi që është bërë nën ndikimin e mjeteve për dehje që nuk janë të ndaluara me fenë, siç është mjalti.

Nuk është shkurorëzim i vlefshëm atëherë kur përdoren e mjete për të cilat nuk e di se do ta bëjnë të dehur ose kur detyrohet në përdorimit e tyre.

Shkurorëzimi i këtyre dy rasteve nuk është i vlefshëm ngase nuk është bërë me dije dhe ata konsiderohen në cilësinë si i çmendur dhe e kanë humbur drejtpeshimin e çështjeve pa dëshirën dhe pa dijen e tyre.

Shkurorëzimi në gjendje të zemëruar

Nëse gjatë zemërimit të butë bëhet shkurorëzimi, shkurorëzimi konsiderohet i vlefshëm, pra, kjo, nëse nuk e ka humbur vetëdijen nga ky zemërim.

Nëse zemërimi është i madh, dhe ai flet pa lidhje si i dehur, shkurorëzimi nuk është i vlefshëm sepse në atë gjendje as mendja dhe as sjelljet e tij nuk bëhen me dëshirën e vërtetë të tij.

Shkurorëzimi i shprehur me tallje

Shkurorëzimi i shprehur me tallje është i vlefshëm, pasi nuk ekziston arsye që të vërtetohet një shkurorëzim i këtillë. Nuk mund të ketë tallje dhe argëtime në çështje serioze, siç është shkurorëzimi.

Shkurorëzimi i paqëllimtë

Njëri ndër kushtet e shkurorëzimit është ekzistimi i qëllimit nga ana e bashkëshortit. Shkurorëzimi nuk do të bëhet me një shprehje të gabuar, duke dashur të thuhet diçka tjetër. Në ajete dhe hadithe është shpallur se robi nuk është përgjegjës për punët e bëra gabimisht ose në harresë.

Shkurorëzimi i të çmendurit

Shkurorëzimi i të çmendurit si dhe i njeriut që vuan nga skleroza nuk është i vlefshëm. Shkurorëzimin që e kanë kryer ata, me ligj llogaritet sikur të mos jetë bërë, meqë nijeti (qëllimi dhe dëshira) ka munguar tek ata.

KAPITULLI I DYTË

IDDETI

IDDETI

IDDET do të thotë numërim, pritje.

Ndërsa në terminologji IDDET quhet: Koha e kufizuar me ligj për t'i definuar dhe për t'i përfunduar çështjet të cilat rezultojnë prej shkakut dhe gjurmëve të martesës nëse ndodh shkurorëzimi.

IDDETI në shkurorëzim është VAXHIB, që do të thotë detyrë e obliguar.

Iddet është kur bashkëshortja duhet të qëndrojë në shtëpinë e burrit gjatë periudhës së pritjes dhe burrit i ndalohet ta përzër nga shtëpia. Kjo është një mënyrë që burri të kthehet te gruaja e tij, ta mbledhë veten dhe të mos vazhdojë divorcin. Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: **“O pejgamber! Nëse (vendosni që t’i) shkurorëzoni gratë, shkurorëzoni ato para kohës së tyre të pritjes (në fillimin e kohës së pritjes, pra në pastrimin nga menstruacionet në të cilin gruaja nuk është prekur me kontakt seksual). Llogaritni kohën e tyre të pritjes dhe frikësojuni Allahut, Zotit tuaj. Mos i dëboni ato prej shtëpive të tyre, por edhe ato të mos largohen, me përjashtim të rastit kur e shkelin martesën haptazi. Këto janë urdhërimet e Allahut, kushdo që i kapërcen kufijtë e Allahut, i ka bërë dëm vetes. Ti nuk e di se pas kësaj Allahu mund të sjellë ndonjë rrethanë tjetër.”** (Et-Talak : 1)

Shpjegim tipik i këtij rregulli është se kërkohet të vërtetohet se a ka mbetur gruaja me barrë.

Po që se paraqitet barra, ajo duhet të presë deri në lindjen e fëmijës, në mënyrë që të sigurohen legjitimiteti dhe identiteti i fëmijës. Zoti i Lartmadhëruar në Kur’an thotë:

“Ndërkaq, (nëse paraqitet shtatzënia) për shtatzënat afati i pritjes së tyre është deri sa të lindin.” (Et-Talak : 4)

Kjo pritje e gruas në shtëpinë e burrit edhe pas shkurorëzimit, në sheriatin islam quhet IDDET.

Ndryshe, iddetin mund ta përkufizojmë si periudha e pritjes, një kohë e provës, e rishqyrtimit, me fjalë tjera mund të konsiderohet si një masë preventive dhe si pikëkontrolli i fundit.

Gruaja, shkurorëzimi i së cilës është inicuar dhe shpallur nga burri, ka të drejtë të plotë për mirëmbajtje të tërësishme përderisa është në periudhën e pritjes – IDDETIT. Burri është plotësisht përgjegjës për ushqimin e saj, veshmbathjen dhe, po që se është e nevojshme, për shërbimin, njësoj sikur martesa të ishte plotësisht e paprekur, gjatë së cilës kohë ajo me siguri do të ishte përshtatur ndaj ndërrimeve të reja në jetën e saj.

Ajo ka të drejtë të vazhdojë të banojë në të njëjtin vend si edhe para shkurorëzimit, ose të furnizohet me pajisje relativisht komfore për vendbanim.

Ajo nuk duhet të përjashtohet nga shtëpia e vet, e as që duhet të dalë nga aty, pos nëse nuk ka kryer ndonjë kundërvajtje të qartë turpëruese.

Allahu i Lartësuar thotë: **“...Këto janë dispozita të Allahut, pra mos i kundërshtoni, sepse kush i tejkalon dispozitat e Allahut, pikërisht të tillët janë zullumqarët.”** (El-Bekare : 229)

Pastaj thotë: **“...Dispozitat e Allahut mos i merrni për shaka. Përkujtoni të mirat e Allahut, ndaj jush edhe atë që ju shpalli Kur’anin dhe dispozitat e sheriatit me të cilat ju udhëzon, dhe keni frikë Allahun e dini se Allahu është i Gjithëdijshtëm për çdo send.”** (El-Bekare : 231)

Burri duhet të shpenzojë për gruan e ndarë e që mund të kthehet, sepse gjatë IDDETIT ajo është ende bashkëshorte e tij.

Gruaja qëndron në shtëpinë e burrit në një gjendje e pamje sa më të mirë e më të bukur dhe nuk mbulohet para burrit; përkundrazi, është mirë të zbukurohet dhe stoliset për të.

Burri ka të drejtë ta rikthejë gruan si bashkëshorte të veten dhe të mos e vazhdojë shkurorëzimin për sa kohë që periudha e pritjes nuk ka mbaruar.

Llojet e IDDETIT

Iddeti ndryshon varësisht prej formës së ndarjes bashkëshortore dhe varësisht prej gjendjes së gruas.

**IDDET inekzistent;
IDDETI me tri menstruacione;
IDDETI me tre muaj të kalendarit hënor;
IDDETI me katër muaj e dhjetë ditë;
IDDETI deri sa të lind fëmija.**

IDDETI INEKZISTENT

Nëse burri është martuar me gruan me akt martesor dhe nuk ka hyrë tek ajo (pra, vetëm sa ka lidhur aktin e martesës dhe nuk ka pasur marrëdhënie intime ose nuk është veçuar me të atëherë) ajo nuk ka IDDET.

Kështu pra, nëse pas aktit të kurorëzimit ndodh deri te ndonjë mospajtim, apo burri e shkurorëzon pa u vetmuar, dhe pa kryer marrëdhënie intime, atëherë gruas nuk i takon mehri i plotë por i takon gjysma e mehrit.

Këtë e tregon Zoti i Madhëruar në ajetin kur'anor:

“E nëse i lëshoni (shkurorëzoni) ato para se të kontaktoni, por u keni caktuar atyre një caktim (mehr in e kurorës), atëherë t’u jepni gjysmën e asaj që e keni caktuar...” (El-Bekare : 237)

Ndodh që akti i kurorëzimit është bërë, mirëpo gjatë aktit të kurorëzimit nuk është caktuar shuma e mehrit, atëherë gruas i takojnë rrobat dhe përgatitjet tjera që quhen METAË. Këtë e potencon Zoti i Madhëruar në ajetin kur'anor:

“Nuk është mëkat për ju nëse i lëshoni (shkurorëzoni) gratë pa pasur kontakt martesor me to dhe para se t’u caktoni atyre ndonjë caktim (Mehr in), po pajisni ato (me pajisje METAË)...” (El-Bekare : 236)

Efektet juridike të mosekzistimit të IDDETIT

Nëse burri e shkurorëzon gruan pa kontaktuar intimisht, rrjedhin këto efekte juridike:

- Nuk ka nevojë për iddet;
- Bashkëshortja, që në momentin e thënies “Je e shkurorëzuar” ajo mund të shkojë në shtëpinë e saj dhe nuk pret ndonjë afat të caktuar (iddet);
- Ajo ka të drejtë për martesë me dikë tjetër; dhe
- E merr gjysmën e mehrit.

Argument i këtij iddeti është Kur’ani

Argument se gruaja nuk ka iddet nëse shkurorëzohet pa u veçuar me burrin dhe pa pasur marrëdhënie intime është ajeti kur'anor ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“O ju që besuat, kur të keni lidhur kurorë me besimtares e pastaj i lëshoni ato para se të keni kontaktuar me to, ju nuk keni të drejtë të kërkonit që ato të presin afatin e caktuar (iddetin), po jepuni diçka atyre dhe lironi në mënyrë të njerëzishme.” (Ahzab : 49)

Iddeti me tri menstruacione

Nëse femra shkurorëzohet dhe ajo ka menstruacione, ajo duhet të pret tri menstruacione, e kjo nëse burri ka pasur marrëdhënie intime.

Për gruan që i vijnë të përmuajshmet, periudha e pritjes është tre cikle të plota menstruacionesh pas shkurorëzimit. Pra, t'i vijnë menstruacionet e të pastrohet, pastaj t'i vijnë sërish manstruacionet e të pastrohet dhe t'i vijnë së treti menstruacionet e të pastrohet; këto janë tre cikle të plota, sado që të zgjasë periudha midis tyre. Pasi të marrë gusël (të bëjë larjen e të gjithë trupit) pas pastrimit të tretë, periudha e saj e pritjes përfundon.

Që nga ai moment, minimumi i qëndrimit të gruas në shtëpinë e burrit është tri kohëra të menstruacionit.

Argument i këtij iddeti është Kur'ani

Argument se gruaja e shkurorëzuar duhet të pres tri menstruacione është ajeti kur'anor ku Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

“Të shkurorëzuarat le të presin afatin prej tri kohërave të menstruacionit.” (El Bekare : 228)

Iddeti tre muaj të kalendarit hënor

Nëse femra shkurorëzohet dhe ajo nuk ka menstruacione, atëherë IDDETI është i përcaktuar tre muaj të plotë të kalendarit hënorë.

Argument i këtij IDDETI është Kur'ani

Zoti i Madhëruar në Kur'anin fisnik thotë:

“E ato gratë tuaja, të cilave u është ndërprerë cikli mujor (menstruacioni), nëse nuk e keni ditur, koha e pritjes së tyre është tre muaj të plotë, e ashtu edhe ato që ende nuk kanë pasur menstruacion...” (Et-Talak : 4)

Iddeti katër muaj e dhjetë ditë

Martesa është bashkësi jetese e vazhdueshme e një burri dhe e një gruaje e ajo duhet të jetë e përhershme dhe e përjetshme. Edhe këto martesat marrin fund, përkatësisht shuhen në mënyrë natyrore, me vdekje. Kështu, shkak për zgjidhjen apo shpëputjen e kësaj martese është vdekja e bashkëshortit. Prandaj, mund themi se vdekja është mënyrë e zakonshme e zgjidhjes së martesës së plotfuqishme.

Nëse burri vdes, pas vetmimit me nusen ose pas marrëdhënieve intime, atëherë IDDETI është katër muaj e dhjetë ditë.

Argument i këtij iddeti është Kur'ani

Zoti i Madhëruar në Kur'anin fisnik thotë:

“E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë”. (El-Bekare : 234),

Nëse femra shkurorëzohet, mirëpo gjatë pritjes së IDDETIT vdes burri, atëherë prej momentit të vdekjes ndërpritet IDDETI i shkurorëzimit dhe fillon numërimi apo fillon IDDETI tjetër, pra IDDETI për shkak të vdekjes së burrit. E dihet se IDDETI i gruas për burrin e vdekur është katër muaj e dhjetë ditë.

Zoti i Madhëruar thotë:

“E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë.” (El-Bekare : 234)

Detyrimet që ka vejusha në periudhën e pritjes (zisë/pikëllimit):

Gruaja, së cilës i ka vdekur burri, duhet të mbajë zi gjatë IDDETIT, pra të lërë çdo gjë që zakonet e konsiderojnë zbukurim, qoftë në trup apo në veshje. Kështu ajo: Nuk duhet të vendosë asnjë lloj ere të mirë. Nuk duhet të veshë rroba zbukurimi. Kjo nuk do të thotë që të veshë rroba të zeza, por vetëm të lërë ato rroba që sipas zakonisht janë për zbukurim. Prandaj lejohet të vishen rrobat e zakonshme, të cilat nuk konsiderohen rroba zbukurimi, ndonëse mund të jenë me ngjyra.

Nuk konsiderohet zbukurim pastrimi i trupit dhe rrobave, krehja e flokëve, prerja e thonjve dhe banja. Të gjitha këto lejohen, ashtu siç lejohet që gruaje të dalë nga shtëpia gjatë periudhës së pritjes për nevojat e saj, me kusht që natën ta kalojë në shtëpinë bashkëshortore.

Iddeti deri sa të lindë fëmija

Nëse gjatë IDDETIT paraqitet shtatzënia e gruas apo fillimi i krijimit të embrionit, atëherë IDDETI vazhdon deri sa të lindë fëmija. Periudha e pritjes për gruan shtatzënë: mbaron me lindjen e fëmijës, sado e gjatë a e shkurtër të jetë kjo kohë.

Argument i këtij iddeti është Kur'an

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

“Ndërkaq, (nëse paraqitet shtatzënia) për shtatzënat afati i pritjes së tyre është deri sa të lindin.” (Et-Talak : 4)

Gruaja e ndarë përfundimisht bëhet e ndaluar për burrin sapo të ndodhë shkurorëzimi. Ajo nuk qëndron me burrin në shtëpi dhe nuk përfiton shpenzime prej tij, përveçse kur është shtatzënë. Në këtë rast burri shpenzon për të derisa ajo të lindë. Më pas burri shpenzon për fëmijën.

Shihet se gruaja nuk mund të shkurorëzohet para se të dalë nga perioda e ‘menstruacionit’ dhe ‘lehonisë’ apo gjersa të kryhet lindja.

Nevoja e pritjes së një kohe shpesh është hapësirë për pushim në të cilin ndjenja e butësisë dhe emocionit të mashkulli qetësojnë zemërimin dhe ndikojnë që të largohet shkurorëzimi.

ÇKA REZULTON NË KOHË TË IDDETIT?

Në kohën e iddetit rezultojnë çështje të caktuara e ato janë:

E para: Nuk ka të drejtë të fejohet;

E dyta: Nuk ka të drejtë të bëj akt të kurorëzimit;

E treta: Nuk ka të drejtë të dalë nga shtëpia e burrit;

E katërta: E drejta për t'u furnizuar;

E pesta: E drejta e pasardhësit;

E gjashta: E drejta e trashëgimisë;

E shtata: Numërimi (llogaritja e shkurorëzimit)

E para: Gruaja nuk ka të drejtë të fejohe.

E shkurorëzuara apo gruas së cilës i vdes burri dhe ajo është në kohën e IDDETIT, duke pasur parasysh se ende ka gjurmë të martesës, me fjalë të tjera ka disa detyra, të drejta dhe obligime martesore deri sa të përfundojë ai afat.

Pa marrë parasysh IDDETI a është për shkak të shkurorëzimit apo të vdekjes ajo nuk lejohet të fejohe gjatë kësaj periudhe kohore.

Është e ndaluar fejesa, edhe haptazi, edhe fshehtazi, sepse Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

“Nuk është mëkat për ju (atëherë kur gratë e shkurorëzuara e kanë kryer afatin e pritjes-IDDETIN) t’iu paraqiteni për martesë grave në mënyrë të tërthortë, ose duke e mbajtur fshehtë në veten tuaj.” (El Bekare : 235)

E deri te pjesa e ajetit Kur'anor:

“Por kurrësi mos u premtoni atyre fshehtazi (diç tjetër për fejesë apo martesë) përpos t’u thoni fjalë të lejuara.” (El-Bekare : 235)

E dyta: Femra në IDDET nuk ka të drejtë të bëjë aktin e kurorëzimit.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Dhe mos bëni akt kurorëzimi (me ndonjë burrë tjetër) deri sa të përfundojë afati i caktuar i (IDDETIT).” (El Bekare : 235)

Nëse bën akt kurorëzimi me ndonjë burrë tjetër gjatë IDDETIT, akti i kurorëzimit është i pavlefshëm sikurse të kishte qenë e martuar, ndërsa me bashkëshortin e saj mund të bëjë akt të kurorëzimit edhe gjatë IDDETIT, sepse koha e pritjes së femrës (IDDETI) është i paraparë për ruajtjen e spermatozoidit, pra të pasardhësve të burrit. E kur të kalojë IDDETI ka të drejtë të martohet me kë të dojë.

Gjatë kësaj kohe (IDDETIT) nëse burri dhe gruaja dëshirojnë të martohen ato mund të martohen pa dëshmitarë dhe pa akt të ri të kurorëzimit dhe pa mehr. Ndërsa prej momentit kur të kalojë IDDETI, nëse burri dhe gruaja dëshirojnë të martohen, ato patjetër duhet të kenë dëshmitarë, të bëjnë akt të ri të kurorëzimit dhe të caktojnë shumë të re të mehrit, e ajo të konsiderohet shumë e mehrit të caktuar.

E treta: Të ndaluarit e daljes nga shtëpia e burrit gjatë kohës së IDDETIT.

Gruaja nuk ka të drejtë të dalë nga shtëpia e burrit, sepse ende është nën përkujdesjen e burrit, e kjo deri sa të kalojë IDDETI. Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

“O ti peygamber (thuaje besimtarëve) kur t'i lëshoni gratë, lëshoni ato në IDDETIN e tyre (afatin e pritjes së tyre) dhe numëroni mirë ditët e afatit të pritjes së tyre, e kijini frikë Allahut, Zotit tuaj, dhe mos i nxirrni ato prej shtëpisë (suaj) e cila tani është edhe e tyre, e edhe ato mos të dalin ndryshe, vetëm nëse bëjnë ndonjë imoralitet të qartë (dhe sillen në vendin për t'u ekzekutuar).” (ET-Talak : 1)

Ebu Hanife thotë se vet dalja është imoralitet.

E katërta: E drejta për t'u furnizuar në shtëpinë e burrit dhe prej shtëpisë së burrit, pra burri financon për shpenzimet e saj.

Deri sa të skadojë afati i IDDETIT, edhe pse gruaja është e shkurorëzuar, obligimin për ushqim dhe veshmbathje e ka burri dhe askush tjetër.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

“...dhe mos i nxirrni ato prej shtëpive të tyre.” (Et Talak : 1)

Gjatë kësaj kohe, deri sa qëndron gruaja në shtëpinë e burrit, ajo nuk ka të drejtë të dalë nga shtëpia, andaj kujdesin për të e ka burri i cili e ka shkurorëzuar, sepse ajo e pret afatin për të shikuar formimin e embrionit, pra ende një pjesë e kujdesit ndaj saj është e burrit, por edhe t'i lihet një afat që t'i rikthehen jetës bashkëshortore.

E pesta: E drejta e pasardhësit.

Nëse gjatë kohës së IDDETIT mbetet gruaja shtatzënë, atëherë ai fëmijë është fëmijë i burrit me të cilin është në IDDET.

E gjashta: E drejta e trashëgimisë.

Nëse ndonjëri prej bashkëshortëve vdes gjatë kohës së IDDETIT, atëherë ka të drejtë të trashëgojë ai i cili është gjallë, pra nëse gruaja vdes, burri e trashëgon atë (nëse pronëson pasuri), por edhe nëse burri vdes gruaja e trashëgon atë.

Po e përsërisim edhe një herë se gruaja gjatë IDDETIT konsiderohet grua në kuptimin e fjalës me të drejta të sheriatit, andaj edhe ka të drejtë trashëgimie, ku Zoti i Madhëruar thotë:

“Juve ju takon patjetër (si trashëgimi) gjysma e asaj (pasurie) që e lënë gratë tuaja, nëse ato nuk kanë fëmijë, por nëse ato kanë fëmijë, juve ju takon patjetër (trashëgimi) një e katërta nga ajo që e lënë ato.” (En-Nisa : 12)

Kjo është pjesa e ajetit ku Zoti i Madhëruar e ka caktuar obligim për të trashëguar burri nga gruaja, ndërsa gruaja në IDDET ende është grua për burrin e saj.

Po ashtu Zoti i Madhëruar ka caktuar edhe pjesën e trashëgimisë së gruas ku thotë:

“Atyre (grave) ju takon patjetër (trashëgimi) një e katërta nga ajo që lini ju, nëse nuk keni fëmijë, por nëse keni fëmijë, atyre ju takon patjetër (trashëgimi) një e teta nga ajo që e lini.” (En-Nisa : 12)

E shtata: Numërimi (llogaritja) i shkurorëzimit.

Shkurorëzimi ka kufi të caktuar, pra nuk lejohet të bëhet shkurorëzimi në mes të bashkëshorte në numër të pacaktuar, për shkak se burri nuk ka të drejtë ta shkurorëzojë gruan më shumë se tri herë.

E shkurorëzuara mund të rikthehet në tri lloje të rasteve:

– Shkurorëzimi me të drejtë kthimi: Përderisa e shkurorëzuara është në iddet, burri mund ta rikthejë në martesë normale pa pasur nevojë të paguajë mehr të ri, pa dëshmitarë dhe pa akt të ri, por ky shkurorëzim numërohet në statistikën e shkurorëzimeve. Ky lloj mund të aplikohet në shkurorëzimin e parë dhe të dytë, por jo edhe në të tretin.

– Nëse gruas së shkurorëzuar me të drejtë kthimi (talak rekh'ij) i kalon pritja (iddet), me fjalë tjera ajo më nuk jeton në shtëpinë e burrit, atëherë ky shkurorëzim shndërrohet në bain bejnune sugra, që do të thotë se burri nuk e posedon më të drejtën e rikthimit (sikurse në rastin e parë) pa mehr të ri, dëshmitarë dhe akt të ri.

– Nëse e shkurorëzon për së treti herë, atëherë ajo grua është ndaluar me ndalesë të përkohshme, që do të thotë se pas herës së tretë ajo vazhdon jetë të re, martesë të re dhe vetëm pas shkurorëzimit të kësaj martese, ndërpritet ndalesa e përkohshme dhe burri në fjalë ka të drejtë ta kërkojë, ta fejojë dhe ta martojë. Për këtë arsye më parë theksonim se shkurorëzimi numërohet në statistikën e shkurorëzimeve.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

“Shkurorëzimi është dy herë, e pastaj burri ose ta vazhdojë (një herë e përgjithmonë) një jetë bashkëshortore të njerëzishme, ose një shkurorëzim me mirëkuptim.” (El-Bekare : 229)

“E në qoftë se ai (burri) e shkurorëzon atë (për të tretën herë), nuk i lejohet ta martojë (ndalesë e përkohshme) deri sa të martohet ajo me një burrë tjetër. E nëse ai (burri i dytë) e shkurorëzon atë, atëherë (lejohet martesa) për ata të dy po që se mendojnë se kanë për t'i zbatuar dispozitat e Allahut, nuk ka pengesë të rikthehen (në bashkëshortësi).” (El-Bekare : 230)

Kujdestaria ndaj fëmijëve

Fëmijët e vegjël mbeten nën kujdestarinë e nënës së tyre të shkurorëzuar, pos, nëse ajo nuk është e aftë.

Shkurorëzimi si i tillë nuk e diskualifikon apo prek të drejtën e saj të kujdestarisë. Derisa ajo i ushqen fëmijët e vegjël dhe kujdeset për të tjerët, përgjegjësia është e babait që të bartë të gjitha shpenzimet e këtij kujdesi dhe në mënyrë të drejtë ta shpërblejë nënën për këtë gjë.

Babai është përgjegjës për strehimin, veshmbathjen dhe ushqimin e tyre, madje edhe po qe se ata janë nën kujdestarinë e nënës apo në shtëpinë e saj. Derisa kjo gjë mund të jetë një burim i mundshëm i tensionit dhe i padisë, po ashtu mund të jetë një masë për pajtim dhe harmoni.

Islami mbron gjenezën familjare. Fëmija është fryt i babait të vet dhe bartës i karakteristikave të tij. Gjatë jetës së tij, fëmija është kënaqësi e syve të tij, si dhe pas vdekjes së tij, fëmija është vazhdim i ekzistimit dhe reprezentues i pavdekshmërisë së tij. Ai i trashëgon cilësitë dhe atributet e babait, ashtu siç i trashëgon karakteristikat dhe veçoritë pozitive e negative, të mira e të këqija. Fëmija është pjesë e zemrës së babait dhe e trupit të tij. Për këtë shkak, Zoti ndalon kurvërinë dhe obligon martesën për ta ruajtur rrjedhën e të mos përzihen spermat, ngase do të ishte e pamundshme njohja e babait të vërtetë të fëmijës, apo prindi t'i njohë vajzat dhe djemtë e vet!

Përmbajtja:

KAPITULLI I PARË	2
SHKURORËZIMI	2
HISTORIA E SHKURORËZIMIT	3
SHKURORËZIMI	4
Dispozita e shkurorëzimit	5
Arsyet e shkurorëzimit	6
E DREJTA E BURRIT PËR SHKURORËZIM	10
Shkurorëzimi në bazë të lejimit apo moslejimit.....	10
Shkurorëzimi në bazë të ribashkimit.....	11
Shkurorëzimi në bazë të kohës dhe mënyrës	16
Shkurorëzimi nga ana e gruas	19
E drejta e gjykatës për shkurorëzim.....	23
Dallimi në mes të shkurorëzimit dhe anulimit të martesës	25
Procesi deri te shkurorëzimi.....	26
Gjendjet në të cilat pranohet dhe gjendjet në të cilat nuk pranohet shkurorëzimi	27
KAPITULLI I DYTË	28
IDDETI	28
IDDETI	29
Llojet e IDDETIT	31
IDDETI INEKZISTENT	32
Iddeti me tri menstruacione	33
Iddeti tre muaj të kalendarit hënor	33
Iddeti katër muaj e dhjetë ditë.....	34
Iddeti deri sa të lindë fëmija.....	35
ÇKA REZULTON NË KOHË TË IDDETIT?	36